

Emri i Lëndës : Gjuhë Shqipe I							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
ALB 101	B	Vjeshtë	4.00	0.00	0.00	4.00	5.00
Lektori		Rahim Ombashi, Prof. Asoc. Dr.					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Anglisht					
Niveli i lëndës		Bachelor					
Përshkrimi		Gjuha është një element shumë qendror në jetën e njeriut. Ajo ndihmon si realizimin e komunikimit, ashtu edhe formësimin e mendimit dhe transmetimin e tij. Për këtë arsye, një përdorim i saktë dhe sa më i mirë i gjuhës na ndihmon si në procesin e njohjes, ashtu edhe në vetë prezantimin e personalitetit tonë. Ky kurs synon t'i aftësojë studentët me një përdorim korrekt dhe sa më të mirë të shqipes, të përmirësojë aftësitë e tyre në shkrimin e shqipes dhe t'i ndihmojë në ndërtimin e një ligjërimi të rrjedhshëm.					
Objektivat		•Të njihet studenti me rregullat themelore të artit të të shkruarit. •Të përvetësohen çështje të normës morfologjike dhe sintaksore. •Të arrijnë studentët një akt të lartë komunikativ, nëpërmjet ligjëritimit normativ. •Të bëjnë punime me nivel të lartë gjuhësor (ese, detyra kursi dhe punim diplome). •Të nxitet të vështruarit kritik dhe akti i korrektimit në rastet e devijimeve nga shqipja standarde.					
Konceptet Kryesore							
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Kulturë gjuhësore: Arti i të shkruarit. - Rregulla të krijimit, fazat, planifikimi, shkrimi i krijimit, teksti, lidhëzat e tekstit . Shqipja letrare						
2	Paragrafi. Paragrafi. Citimet dhe shënimet. Radhitja dhe përgatitja për shtypje e një dokumenti						
3	Redaktimi dhe korrektimi. Redaktimi. Korrektimi. Shenjat e korrektimit						
4	Gramatika e komunikimit. gjuha standarde shqipe. Normat e shqipes standard. Shprehitë						
5	Emri. Gjinia. Trajta. Emrat e përveçëm						
6	Përemri. Kuptimi, veçoritë gramatikore. Ndryshime dhe ngjashmëri						
7	Folja. Klasat e foljeve. Prejardhja e formave foljore. Folje me dysorë. Mënyra urdhërore						
8	Provim gjysmëfinal (MIDTERM). Çështje sintaksore. Rendi i gjymtyrëve në fjali						
9	Përshtatja e gjymtyrëve në fjali						
10	Përshtatja e kohëve në periudhën me nënrenditje						
11	Ndërtime shqipe në vend të ndërtimeve të huaja. Parafjala						
12	Ndërtime shqipe në vend të ndërtimeve të huaja. Shprehje parafjalore...						
13	Pastërtia e leksikut. Miqtë e rremë ((gr. παρόνυμ-paronimet)...						
14	Pastërtia e leksikut. Ushtrime						
15	Përsëritje. Ushtrime						
16	Provim Final						

Parakushtet	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.
Literatura	• Cikël leksionesh nga lektori i lëndës. (Ky cikël leksionesh është hartuar duke u bazuar si në literaturën e detyrueshme, ashtu edhe në atë të këshillueshme, pra është një përmbledhje e koncepteve themelore të lëndës). • Rami Memushaj, Shqipja standarde, Toena, Tiranë, 2002. • Bahri Beci, Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë, Tiranë: Botimet EDFA, 2004.
Referenca të tjera	• Gjovalin Shkurtaj, Kultura e gjuhës, Tiranë: SHBLU 2006. • Shaban Demiraj, Prejardhja e shqiptarëve nën dritën e dëshmimeve të gjuhës shqipe, Tiranë: shtëpia botues "Shkenca", 1999 • Robert Elsie, Historia e Letërsisë shqiptare. • Shaban Demiraj, Gjuha shqipe dhe historia e saj, Tiranë: SHBLU, 1988, f. 247-276.

Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat

1	Studentët do të pajisen me njohuritë bazë të gjuhës dhe do të dinë të shkruajnë pa gabime drejtshkrimore.
2	Studentët do të mund të përkthejnë më mirë nga gjuhët e huaja tekste të ndryshme, duke njohur në mënyrë rrënjësore gjuhën amtare.
3	Studentët do të arrijnë të shkruajnë ese, njoftime, deklarata etj., në mënyrë koherente dhe të saktë.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës

Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja
Gjysmë finale	1	20
Kuize	1	5
Projekte	1	20
Projekte semestrale	0	0
Punë laborator	0	0
Pjesëmarrja në mësim	1	5
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final		50
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final		50
Total		100

Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)

Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	4	64
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	2	28
Detyra	1	0	0
Gjysmë finale	1	10	10
Provimi final	1	20	20
Të tjera	1	5	5
Ngarkesa totale e orëve			127
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5.08
ECTS			5.00